5. Alarmim i opinionit për shkeljet më të rënda të të drejtave të njeriut nëpërmjet konferencave të rregullta për shtypin, brifingje dhe lajmërimet (alarme)
6. Zbatim i hulumtimit për kuptimin nga qytetarët të të drejtave të njeriut
7. Shpallje raportit vjetor për gjendjen e të drejtave të njeriut
8. Koordinim të Rrjetit joformal për mbrojtjen nga diskriminimi
9. Mbikëqyrje e tubimeve publike, protestave, grevave.

Për aktivitetin 6, përkatësisht zbatim të hulumtimit për kuptimin e qytetarëve të të drejtave të njeriut është angazhuar Instituti për Shkenca Shoqërore dhe Humaniste – Shkup, i cili e ka zbatuar hulumtimin dhe ka përgatitur këtë raport ku jepen të dhëna të sakta për rezultatet e hulumtimit, si dhe analizë dhe rekomandime për veprime/aktivitete në të ardhmen për zmadhimin e informimit të qytetarëve për të drejtat e veta dhe për mekanizmat për mbrojtjen e tyre.

2. METODOLOGJIA DHE PROCEDURA QË JANË PËRDORUR GJATË ZBATIMIT TË HULUMTIMIT

HYRJE

Kjo pjesë e raportit përmban përshkrimin e metodologjisë dhe procedurën që është përdorur në zbatimin e hulumtimit. Hulumtimi i realizuar në suazat e Projektit “Zmadhimi i transparencës dhe përmirësimi i mbizotërimit të të drejtës nëpërmjet ndjekjes dhe informimit për shkeljen e të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë”, të cilin e zbaton Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Maqedonisë, është mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur Maqedonia dhe përfshin: mendime, kuptime dhe informim të qytetarëve në lidhje me të drejtat e njeriut dhe institucionet të cilat merren me këto pyetje dhe të cilat duhet t’i mbrojnë këto të drejta. Qëllimi i hulumtimit është të merren të dhëna mbi informimin e qytetarëve për të drejtat e njeriut dhe për mekanizmat për mbrojtje gjatë shkeljes së tyre.

Nga 9 deri më 30 dhjetor 2014, Instituti i Shkencave Shoqërore dhe Humaniste - Shkup, ka zbatuar hulumtim të mendimit publik të banorëve në tetë rajone të R. së Maqedonisë, rajonit të: Vardarit, Lindor, Jugperëndimor, Juglindor, Pellagonisë, Pollogut, Verilindor dhe Shkupit. Në faza të ndryshme gjatë procesit të hulumtimit (përgatitjes së instrumenteve, ekzemplarit, mbledhjes së të dhënave, futjes së të dhënave, përpunimit dhe analizimit të tyre) janë përfshirë dhjetë hulumtues.

EKZEMPLAR

Ekipi i Institutit të Shkencave Shoqërore dhe Humaniste - Shkup për këtë hulumtim ka përdorur ekzemplar nacional reprezentativ nëpërmjet metodologjisë për zgjedhje dhe procedurës për seleksionim me zgjedhje të rastësishme të të anketuarve, duke ndjekur karakteristikat demografike të rajoneve në R. e Maqedonisë. Ekzemplari ka përfshirë 1001 të anketuar. Të dhënat e detajuara të ekzemplarit janë dhënë më poshtë në raport.

METODA

Për nevojat e hulumtimit u bë pyetësor për anketim i përshtatshëm për anketim telefonik i cili është përzgjedhur si metoda më kompetente për hulumtim të mendimit dhe informimit të ekzemplarit reprezentativ të qytetarëve të R. së Maqedonisë. Pyetësori përbëhet nga pyetje me mundësi për zgjedhje të përgjigjeve të ofruara, si dhe pyetje për karakteristikat demografike të të anketuarve.

PROCEDURA

Më 9 dhjetor 2014 në hapësirat e Institutit të Shkencave Shoqërore dhe Humaniste - Shkup është mbajtur trajnim për anketuesit dhe mbikëqyrësit (supervizorët). U diskutuan pyetësorët, të gjitha pyetjet janë lexuar dhe janë shpjeguar secila më vete. Si pjesë e instruksioneve, të anketuarit janë këshilluar të mos i lexojnë përgjigjet “nuk e di”.

Seleksionimi i amvisërive është bazuar në metodën e zgjedhjes së rastësishme, ku të njëjtët janë kontaktuar në telefon, duke përdorur adresarin e numrave telefonikë të Telekomit të Maqedonisë. Amvisëritë janë përzgjedhur sipas një hapi të përcaktuar në varësi të numrit ekzistues të numrave telefonikë të tri-dhjetë komunave. Nëse ndodhte që numri të mos ekzistonte, anketuesi telefononte në numrin që vijon të adresarin e numrave. Çdo anketues duhej të telefononte të paktën tri herë që të vendoste kontakt me amvisërinë. Në rast se nuk përgjigjej askush as pas thirrjes së tretë, përdorej e njëjta procedurë, telefonohej numri në vijim nga adresari i numrave. Është shpjeguar edhe procedura e përzgjedhjes së të anketuarve për të gjithë nënëkzemplarët (sipas përkatësisë etnike dhe pjesës rurale-urbane).

Çdo ditë, anketuesit kishin obligim ta informojnë personin përgjegjës të hulumtimit për vështirësitë eventuale të cilat i kanë pasur gjatë telefonimit.

Mbikëqyrësit ishin trajnuar për mënyrën e zbatimit të monitorimit dhe supervizionit të procesit të anketimit. Kontrolli i procesit të anketimit është bërë para vendosjes së të dhënave. Çdo mbikëqyrës duhej t’i kontrollonte anketat me një prej metodave të kontrollit, përkatësisht të kontrollojë minimum 60% të të anketuarve.

Vendosja e anketave është kryer nga dy koderë (persona përgjegjës për vendosjen e të dhënave). Për vendosjen dhe përpunimin e të dhënave është përdorur softuer profesional paket SPSS për Uindous (Windows).

Mjetet për mbledhjen e të dhënave (pyetësorët) janë konstruktuar nga anëtarët e ekipit hulumtues në bashkëpunim me kërkuesin e hulumtimit.

Procesi i anketimit është kryer nga tetë anketues. Ai është ndjekur dhe kontrolluar nga dy mbikëqyrës.

Hulumtimi filloi me anketim pilot, me qëllim që të përcaktohet cilësia e pyetësorëve dhe kuptimshmëria e pyetjeve. Ajo vërtetoi se një pjesë e pyetjeve duhej të korrigjohej. Pas korrigjimit vijoi një anketë e re pilot, e cila përcaktoi se pyetjet janë të qarta dhe të kuptueshme dhe të njëjtat janë përdorur gjatë anketimit.

Numri i refuzimeve të anketës (nga personat e kontaktuar) ishte në suazat e asaj që pritej, 68 refuzime gjithsej (për shkak se ishin të zënë ose nuk kishin vullnet t'i përgjigjen anketës), me çka mund të nxirret përfundim se nuk ka pasur lëvizje nga ekzemplari i përcaktuar.

Anketa është përfunduar në periudhën e paraparë kohore prej tri javësh dhe përfundoi më 30 dhjetor 2014.

3. KARAKTERISTIKA DEMOGRAFIKE TË EKZEMPLARIT

Në lidhje me të dhënat demografike të të anketuarve, janë marrë këto informacione:

D1. Gjinia

Ekzemplari ka përfshirë 47,9% meshkuj dhe 52,1% femra.

D2. Përkatësia etnike

Sipas përkatësisë etnike të të anketuarve, është marrë struktura në vijim:

Tabela 1

	Frekuenca	Përqindja
Maqedonas/e	682	68,1
Shqiptar/e	239	23,9
Turk/e	21	2,1
Rom/e	23	2,3
Serb/e	17	1,7
Vllah/e	10	1,0
Boshnjak/e	5	0,5
Të tjerë	4	0,4
Gjithsej	1001	100,0

D3. Arsimi

Sipas strukturës arsimore të të anketuarve, përqindja më e madhe (49,3%) janë ata me arsim të mesëm të përfunduar. 3,8% të të anketuarve nuk kanë mbaruar arsim tetëvjeçar, kurse 20,8 janë me arsim tetëvjeçar. Me 24,3% janë ata që kanë kryer arsimin e lartë, kurse me magjistraturë përkatësisht doktoraturë janë vetëm 1,9% e të anketuarve.



D4. Mosha

Nga aspekti i moshës së të anketuarve është marrë kjo strukturë:

Tabela 2

Moshë	Frekuenca	Përqindja
Nga 18 deri në 25 vjet	95	9,5
Nga 26 deri në 35 vjet	193	19,3
Nga 36 deri në 45 vjet	188	18,8
Nga 46 deri në 55 vjet	172	17,2
Nga 56 deri në 65 vjet	203	20,3
Mbi 66 vjet	150	15,0
Gjithsej	700	100,0

D5. Komuna

Me këtë ekzemplar janë përfshirë këto komuna:

Komuna	Frekuenca	Përqindja
Berova	9	0,9
Manastiri	60	6,0
Dibra	14	1,4
Dellçeva	10	1,0
Gjevgjelia	22	2,2
Gostivari	32	3,2
Kavadarci	20	2,0
Kiçeva	21	2,1
Kočani	24	2,4
Kratova	11	1,1
Kriva Pallanka	20	2,0
Krusheva	8	0,8
Kumanova	69	6,9
Makedonska Kamenica	7	0,7

Negotina	14	1,4
Novo Sello	6	0,6
Ohri	36	3,6
Prilepi	71	7,1
Probishtipi	10	1,0
Radovishi	12	1,2
Resnja	9	0,9
Shkupi	301	30,1
Shtipi	30	3,0
Struga	38	3,8
Strumica	30	3,0
Sveti Nikolla	10	1,0
Tetova	54	5,4
Velesi	34	3,4
Vinica	14	1,4
Vraneshtica	5	0,5
Gjithsej	1001	100,0

4. ANALIZA E REZULTATEVE TË ANKETËS

P1. Sipas jush çfarë shpjegon më saktë se çfarë janë të drejtat e njeriut?

Në lidhje me atë se çfarë konsiderojnë se e përkufizon dhe e shpjegon më saktë termin të drejtat e njeriut, pothuajse gjysma e të anketuarve (48,2%) konsiderojnë se kjo është e drejta e jetesës në paqe dhe liri. E drejta për liri të lëvizjes dhe zgjedhjes është përgjigja të cilën e kanë përzgjedhur 20% të të anketuarve. Kjo flet se 68,2% e të anketuarve kanë zgjedhur përgjigje të gabuar për këtë pyetje. Opsioni se të drejtat e njeriut janë të drejta që fitohen që në lindje e kanë përzgjedhur 27,8% të të anketuarve

Tabela 5

Sipas jush çfarë shpjegon më saktë se çfarë janë të drejtat e njeriut?	Frekuenca	Përqindja
E drejta e jetesës në paqe dhe liri	483	48,3
Të drejta që fitohen që në lindje	278	27,8
E drejta për liri të lëvizjes dhe zgjedhjes	200	20,0
Nuk e di	40	4,0
Gjithsej	1001	100,0

Duke parë nga aspekti i karakteristikave demografike të të anketuarve, për këtë pyetje nuk ka dallime në aspekt të gjinisë, përkatësisë etnike dhe moshës. Dallimet e vetme shfaqen në raport me arsimin e të anketuarve. Kështu, ata me shkallë më të lartë të arsimit (magjistrat dhe doktorët e shkencave) dhe me arsim të lartë/universitar më shpesh e kanë zgjedhur përgjigjen "të drejta që fitohen që në lindje" (47,4% përkatësisht 42,8%). Të tjerët (arsim tetëvjeçar i papërfunduar, arsim tetëvjeçar dhe i mesëm) kanë zgjedhur e drejta e jetesës në paqe dhe liri.

P2. Cila prej organizatave ndërkombëtare mendoni se është e obliguar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut?

Më pak se gjysma e të anketuarve (37%) konsiderojnë se Organizata e Kombeve të Bashkuara është organizata ndërkombëtare e cila ka obligim mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Mund të vihet re se një përqindje e caktuar e të anketuarve tregojnë mosnjohjen e institucioneve ndërkombëtare të cilat kanë obligim të drejtat e njeriut: NATO, OSBE..

Gjithashtu, më tepër se 20% e të anketuarve (20,6%) janë shprehur se nuk dinë se cila organizatë ndërkombëtare ka obligim mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Meqenëse pyetja ishte gjysmë e hapur, të anketuarit kishin mundësi të plotësonjë organizata në listë, përkatësisht të japin përgjigje të vet që nuk është midis atyre të ofruara, kështu që, si përgjigja e dhënë më shpesh përveç atyre të dhëna, me pothuajse 5% ishte se asnjë organizatë ndërkombëtare nuk i mbron të drejtat përkatësisht nuk kanë besim në këto organizata.

Tabela 6

Cila prej organizatave ndërkombëtare të dhëna mendoni se është e obliguar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut?	Frekuenca	Përqindja
Këshilli i Evropës	195	19,5
NATO	75	7,5
Kombet e Bashkuara	371	37,1
OSBE	101	10,1
Nuk e di	206	20,6
Asnjë	49	4,9
Të gjitha	1	0,1
Policia	2	0,2
Gjykata në Strasburg	1	0,1
Gjithsej	1001	100,0

Në aspekt të gjinisë dhe moshës nuk ka dallime në lidhje me këtë pyetje. Sipas arsimit, opsioni i vetëm nuk e di ishte përzgjedhur nga gjysma e të anketuarve që nuk kanë përfunduar arsimin tetëvjeçar. Përgjigjet e tjera përputhen me frekuencën e përgjithshme. Parë në aspektin e përkatësisë etnike, është interesant fakti se madje 18% e popullatës shqiptare mendon se NATO-ja ka obligim mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

P3. Cili prej shembujve të dhënë mendoni se është diskriminim

Para së gjithash duhet të thuhet se më tepër se gjysma e personave të anketuar në çdo shembull të dhënë shohin diskriminim. Kështu, përqindja më e madhe e përgjigjeve pohuese janë dhënë për shembullin për shpallje për punësim ku është vendosur se kërkohen vetëm persona femra (68,8%). Përqindja më e vogël e përgjigjeve pohuese (56,4%), kurse njëkohësisht dhe përqindja më e madhe e pasigurisë nëpërmjet opsionit nuk e di (23,7%) janë dhënë në shembullin për tallje dhe ofendim të personit me orientim homoseksual.

Në përgjithësi, për të gjithë shembujt e dhënë ekziston paraqitja e gabuar ose një shkallë e caktuar e mosnjohjes, përkatësisht nuk ekziston vetëdija për faktin a janë shembujt konkretë diskriminim apo jo.

Tabela 7

Shpallje për punësim ku është vendosur se kërkohen vetëm persona femra	Фреквенција	Процент
Po	687	68,6
Jo	207	20,7
Nuk e di	107	10,7
Gjithsej	1001	100,0

Në aspektin e gjinisë dhe moshës midis të anketuarve për shembullin për diskriminim në shpalljen për punësim nuk ka dallime. Sipas arsimit, përqindja më e vogël e të anketuarve 55,3% me arsim tetëvjeçar të papërfunduar u përgjigj në mënyrë pohuese për këtë shembull diskriminimi. Dallimi më i madh shfaqet në aspektin e përkatësisë etnike të të anketuarve. Madje 80% të shqiptarëve konsiderojnë se një shpallje e tillë është diskriminim.

Tabela 8

Mospëlqim i fshehtë për shkak të ardhjes të personave me përkatësi tjetër etnike në fqinjësi.	Frekuenca	Përqindja
Po	633	63,2
Jo	260	26,0
Nuk e di	108	10,8
Gjithsej	1001	100,0

Për shembullin e vetëm i cili nuk është shembull diskriminimi në mënyrë pohuese u shprehën 63,2% e të anketuarve. Kjo flet për informimin e pamjaftueshëm për atë se çfarë është në të vërtetë shembull për diskriminim. Për këtë pyetje nuk ka dallime në aspektin të frekuencave të përgjithshme sipas karakteristikave demografike të anketuarve.

Tabela 9

Tallje dhe ofendim të personit me orientim homoseksual.	Frekuenca	Përqindja
Po	565	56,4
Jo	199	19,9
Nuk e di	237	23,7
Gjithsej	1001	100,0

Siç u përmend dhe më parë, përqindja më e vogël e të anketuarve 56,4%, në raport me shembujt e tjerë të diskriminimit dhe përqindja më e vogël e shembullit që nuk është diskriminim, konsiderojnë se tallja dhe ofendimi i personit me orientim homoseksual është diskriminim.

Kjo pyetje shfaq një ndarje më të madhe të të anketuarve në raport me karakteristikat e tjera demografike. Në raport me arsimit, të anketuarit me shkallën më të ulët të arsimit (arsim tetëvjeçar dhe i papërfunduar tetëvjeçar) kanë numrin më të madh të përgjigjeve të papërcaktuara (42,1% përkatësisht 54,8%). Krahasim, 84,2% e të anketuarve me titullin magjistër dhe doktori i shkencave përkundrejt 23,1% me arsim tetëvjeçar janë dakord se tallja dhe ofendimi i homoseksualëve është diskriminim. Në aspektin e përkatësisë etnike, te popullata shqiptare në krahasim me të tjerët është më e theksuar përgjigja negative 32,6%.

Tabela 10

Nënshkrim i peticionit për përjashtim të fëmijës me nevoja të veçanta nga arsimi i rregullt.	Frekuenca	Përqindja
Po	663	66,2
Jo	159	15,9
Nuk e di	179	17,9
Gjithsej	1001	100,0

Në lidhje me këtë pyetje nuk ekzistojnë dallime në raport me gjininë, moshën dhe përkatësinë etnike. Përsëri tek ata me arsim më të ulët dominon mosnjohuria (36,8%), kurse te të tjerët përgjigjet përputhen me frekuencën e përgjithshme.

P4. Ku mendoni se mund të dorëzoni ankesë në rast diskriminimi?

Në lidhje me pyetjen te cili institucion mund të dorëzohet ankesë në rast diskriminimi të anketuarit kishin mundësi të japin më tepër se një përgjigje. Përgjigjet e mbledhura për këtë pyetje i dhanë këto rezultate. Të anketuarit në pjesën më të madhe konsiderojnë Avokatin e Popullit si institucion ku mund të kërkohet mbrojtje në rast diskriminimi, 31,7%. Në vend të dytë është Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi me 25,5%. Opsioni i tretë i përzgjedhur më shpesh janë organizatat joqeveritare 15,7 %. Dhe rreth dhjetë përqind (10,5%) e të anketuarve nuk dinë se ku të kërkojnë mbrojtje në rast diskriminimi.

Në këtë pyetje kishte mundësi që të anketuarit të japin përgjigje edhe vetë (që nuk është midis përgjigjeve të ofruar). Dhe përsëri si përgjigje që nuk është ofruar, por që është dhënë më shpesh nga të anketuarit (me rreth 10%) ishte asgjëkund, përkatësisht se nga asnjë institucion nuk mund të kërkohet mbrojtje në rast diskriminimi. Kjo e dhënë flet për mosbesimin që ekziston te një pjesë e qytetarëve ndaj institucioneve të cilat duhet t'i mbrojnë ata.

Tabela 11

Ku mendoni se mund të kërkonte mbrojtje në rast diskriminimi?	Frekuenca	Përqindja
Avokati i Popullit	417	31,7
Kuvendi	69	5,3
Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi	348	26,5
OJQ	206	15,7
Nuk e di	138	10,5
Asgjëkund	129	9,8
MPB	1	0,1
Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut	4	0,3
Qendra për Punë Sociale	1	0,1
Organizata ndërkombëtare	2	0,1
Gjithsej	1315	100,0

Parë në aspektin e gjinisë dhe moshës nuk ka dallime të theksuara midis të anketuarve. Në aspektin e arsimit, grupi me arsim tetëvjeçar të papërfunduar është i pari për mosbesim në asnjë institucion (38,5%). Te popullata shqiptare në krahasim me të tjerat ekziston besimi më i madh te Avokati i Popullit me 44,5%.

P5. Sipas Jush, çfarë prej kësaj që është dhënë më poshtë e konsideroni si shkelje të të drejtës së zgjedhjes?

Kjo pyetje ka të bëjë me vetëdijen e të anketuarve në lidhje me të drejtën e tyre të zgjedhjes. Një nga mënyrat që shkelin të drejtën e zgjedhjes është të mos lejohen të votojnë, për të cilën janë përcaktuar dhe 39,2% e të anketuarve.

Megjithatë për përqindjen më të madhe të të anketuarve, blerja e votuesve është përgjigja që është zgjedhur më shpesh në lidhje me shkeljen e të drejtës së zgjedhjes (43,4%). Nuk janë të vogla edhe përqindjet e atyre që kanë thënë se nuk dinë cila prej përgjigjeve të ofruara është shkelje e të drejtës së zgjedhjes, si edhe të atyre që për përgjigje kanë zgjedhur opsionin "shkelje e heshtjes zgjedhore".

Nga këto të dhëna, të prezantuara në tabelën më poshtë, mund të vërehet se ekziston nevoja për informim më të madh të qytetarëve në lidhje me të drejtat zgjedhore.

Tabela 12

Sipas Jush, çfarë prej kësaj që është dhënë më poshtë e konsideroni si shkelje të të drejtës së zgjedhjes?	Frekuenca	Përqindja
Blerja e votuesve	434	43,4
Shkelja e heshtjes zgjedhore	80	8,0
Pamundësim votimi	392	39,2
Nuk e di	95	9,5
Gjithsej	1001	100,0

Opsioni i vetëm që është shkelje e të drejtës së zgjedhjes, përkatësisht pamundësimi për të votuar është përgjigja e cila nuk jep shumë dallime midis të anketuarve në aspektin e gjinisë dhe moshës. Në aspektin e arsimit, ky opsion është përzgjedhur më shpesh nga grupi i mr. dhe dr. me 73,7% përkundrejt 13,9% janë ata me shkollë tetëvjeçare të përfunduar. Në aspektin e përkatësisë etnike, vetëm 16,7% e shqiptarëve e kanë dhënë këtë përgjigje në krahasim me 46,8% të të anketuarve maqedonas.

P6. Në cilat raste polici mund t'ju kërkojë të legjitimoheni ose/dhe t'ju kontrollojë?

Pak më tepër se gjysma e të anketuarve (55,9%) e dinë se nëpunësi policor ka të drejtë t'i kontrollojë ose legjitimojë vetëm nëse ekziston dyshim i bazuar

për kryerje të veprës penale apo për kundërvajtje. Megjithatë të tjerët (ose më saktë 44%) të të anketuarve konsiderojnë se është në rregull kjo të ndodhë në bazë të vlerësimit personal të policit (28,2%), kur lëvizni vetë në mbrëmje në hapësirë publike (8,2), ose thjeshtë nuk e dinë në cilat raste polici mund të legjitimojë/kontrullojë 7,6%.

Në lidhje me të drejtën e lëvizjes, si dhe në pyetjet e mëparshme mund të nxirret përfundimi se te një pjesë e mirë e të anketuarve (44%) mbizotëron mosnjohja e të drejtave të veta

Tabela 13

Në cilat raste polici mund t'ju kërkojë të legjitimoheni ose/dhe t'ju kontrollojë?	Frekuenca	Përqindja
Në bazë të vlerësimit personal të policit	282	28,2
Kur ekziston dyshim i bazuar për kryerje të veprës penale apo për kundërvajtje	560	55,9
Kur jeni vetë në mbrëmje në hapësirë publike	82	8,2
Nuk e di	76	7,6
Në asnjë rast	1	0,1
Gjithsej	1001	100,0

Përgjigja më e saktë se kur ekziston dyshim i bazuar për kryerje të kundërvajtjes është rasti kur polici mund t'ju legjitimojë ose t'ju kontrollojë nuk jep dallime në përgjigje në aspektin e gjinisë dhe përkatësisë etnike. Në aspektin moshës, përgjigje të tilla më shumë ka tek të rinjtë (18-35 vjet), kurse më të rriturit konsiderojnë se kjo varet nga vlerësimi personal i policit. Në aspektin e arsimit, ata me arsim më të ulët konsiderojnë se legjitimimi duhet të kryhet me vlerësim personal të policit (50% e të anketuarve pa arsim tetëvjeçar të përfunduar) përkundërt 72,8% e atyre me arsim të lartë të cilët mendojnë se kjo duhet të kryhet vetëm nëse ekziston dyshim i bazuar.

P7. Sipas Jush, cili prej rasteve të dhëna është pengim i lirisë së shprehjes?

Për këtë pyetje madje gjysma e të anketuarve (50%) konsideron se shembulli më tipik për shkeljen e të drejtës së lirisë së shprehjes është pengimi i mbajtjes së tubimit publik apo protestës. Në vend të dytë është ndalimi i shpalljes së informacionit, lajmit apo evenimentit me 23%. Për 10,8% të të anketuarve

ndalimi i pirjes së duhanit në hapësirë publike, i cili nuk është pengim i lirisë së shprehjes, është shembulli më i hidhur i pengimit të lirisë. Opsioni "nuk e di" është zgjedhur nga 16,3% e të anketuarve.

Tabela 14

Sipas Jush, cili prej rasteve të dhëna është pengim i lirisë së shprehjes?	Frekuenca	Përqindja
Pengimi i mbajtjes së tubimit publik apo protestës	500	50,0
Ndalimi i pirjes së duhanit në hapësirë publike	108	10,8
Ndalimi i shpalljes së informacionit /lajmit/evenimentit	230	23,0
Nuk e di	163	16,3
Gjithsej	1001	100,0

Përsëri edhe për këtë pyetje, janë pothuajse identike përgjigjet e të anketuarve në aspektin e gjinisë. Në aspektin e moshës, 70,5% e të anketuarve në moshë nga 26-35 vjet konsiderojnë se ndalimi i tubimit publik është pengim i lirisë së shprehjes. Grupi më i ri (18-25 vjet) shumica e tyre (34,7%) ndalimin për shpallje të informacionit e konsiderojnë si atak mbi lirinë e shprehjes. Në aspektin e arsimit, tek ata me tituj të lartë (mr. dhe dr.) në vend të parë është përgjigja për pengim të informacionit 63,2%, kurse ndalimi i pirjes së duhanit më tepër shfaqet tek ata me arsim tetëvjeçar 21,6%. Tek popullata shqiptare përqindja më e madhe është për përgjigjen ndalim i tubimit publik (58,2%), kurse me përqindje identike shfaqet ndalimi i botimit të lajmit, por edhe ndalimi i pirjes së duhanit (me nga 19,7%).

P8. Sipas Jush, çfarë nga kjo që është dhënë është fjalor i urrejtjes?

Edhe për këtë pyetje të anketuarit kishin mundësi të japin më tepër se një përgjigje. Përgjigjet e mbledhura për të gjitha opsionet e dhëna e krijojnë pamjen e tabelës në vijim. Si shembulli më i theksuar i fjalorit të urrejtjes ishte ofendimi në bazë të përkatësisë etnike (45%). Vijoje, pothuajse me të njëjtën përqindje, opsionet "Thirrjet me kërcënime për homoseksualë" (24%) dhe ofendimi personal në profilin në Fejsbuk/rrjet social (23%). Ofendim personal në profilin në FB mund të jetë akt i sjelljes së pakulturuar, por thirrja me kërcënime në bazë të orientimit më të ndryshëm seksual është shembull tipik dhe i pranishëm shpesh në fjalorin e urrejtjes.

Në shënimet e anketuesve është shënuar se gjatë përmendjes së termit homoseksual te një pjesë e të anketuarve është shfaqur neveri ndaj anketës dhe është theksuar se ata nuk kanë lidhje me të, përkatësisht ajo është sëmundje. Madje në disa raste gjatë anketës telefonike për homoseksualët janë përdorur fjalë të tjera më ofenduese. Kulmi është arritur në dy raste kur anketa është ndërprerë gjatë përmendjes së shembujve me diskriminim dhe fjalor urrejtje në bazë të orientimit homoseksual.

Tabela 15

Sipas Jush, çfarë nga kjo që është dhënë është fjalor i urrejtjes?	Frekuenca	Përqindja
Ofendimi personal në profilin në Fejsbuk/rrjetet social	363	23%
Ofendimi në bazë të përkatësisë etnike	708	45%
Thirrjet me kërcënime për homoseksualë	374	24%
Nuk e di	112	7%
Gjithsej	1557	100%

Kjo pyetje tregon mospërputhje midis të anketuarve në aspektin e përkatësisë së tyre etnike. Tek të dy grupet etnike më të mëdha (maqedonas dhe shqiptarë) ekziston dallim në aspektin e përgjigjeve. Për të dy grupet shembulli më i mirë për fjalor të urrejtjes janë ofendimet në bazë të përkatësisë etnike. Me 40,7% te maqedonasit dhe madje me 69,3% te shqiptarët. Sipas 39,6% të të anketuarve maqedonas dhe 20,3% të të anketuarve shqiptarë ofendimet personale në rrjetet sociale janë fjalor urrejtjeje. Thirrja e kërcënimeve ndaj homoseksualë në ndeshjet sportive janë fjalor urrejtjeje për 11,9% të maqedonasve dhe vetëm për 5,6% të shqiptarëve.

P9. Sipas Jush, çfarë nga kjo që është dhënë është shkelje e të drejtave ekonomike?

Një prej pyetjeve ishte në lidhje me vetëdijen për të drejtat ekonomike, me fokus te të drejtat e punëtorëve. Përqindja më e madhe e të anketuarve (61%) kanë perceptim të gabuar për të drejtat ekonomike. Pothuajse 40% e të anketuarve konsiderojnë se pamundësi për të gjetur punë në përqindjen më të madhe (39,5%) është shembull i shkeljes së të drejtave ekonomike. Punë në të "zezë" është zgjedhur nga 21,5% e të anketuarve, kurse 5,5% janë shprehur se nuk dinë se cili prej shembujve të dhënë është shkelje e të drejtave ekonomike.

Vetëm një e treta e të anketuarve (33,6%) e kanë zgjedhur opsionin "punë e detyruar me më tepër orë sesa marrëveshja", që në të vërtetë është shkelje e të drejtave ekonomike.

Tabela 16

Sipas Jush, çfarë nga kjo që është dhënë është shkelje e të drejtave ekonomike?	Frekuenca	Përqindja
Pamundësia për të gjetur punë	395	39,5
Punë e detyruar me më tepër orë sesa marrëveshja	336	33,6
Punë në të "zezë"	215	21,5
Nuk e di	55	5,5
Gjithsej	1001	100,0

Sipas gjinisë dhe moshës të anketuarit nuk kanë dallime të dukshme në krahasim me frekuencën e përgjithshme të përgjigjeve. Në aspektin e arsimit, ata me arsim më të ulët (60,5% pa arsim tetëvjeçar dhe 51,9% me arsim tetëvjeçar) konsiderojnë se pamundësia për të gjetur punë është shkelja më e madhe e të drejtave ekonomike. Puna e detyruar me më tepër orë sesa marrëveshja është përgjigja e zgjedhur më shpesh nga 57,9% të atyre me shkallën më të lartë të arsimit (magjistër dhe doktorë të shkencës). Në aspektin e përkatësisë etnike dhe krahasuar me dy grupet me numër më të madh, te maqedonasit mbizotëron qëndrimi se puna e detyruar me më tepër orë është shkelje e të drejtave ekonomike me 36,1% për dallim prej 24,3% e shqiptarëve. Më tepër se gjysma e shqiptarëve (57,7%) si përgjigje më të rëndësishme kanë dhënë pamundësinë për të gjetur punë, në krahasim me 33,1% e maqedonasve.

P10. Sipas Jush, çfarë nga kjo që është dhënë është shkelje e të drejtave sociale?

Si dhe për pyetjet e mëparshme, ashtu edhe për pyetjen për të drejtat sociale kishte mundësi të zgjidhet përgjigja. Shembujt e vërtetë të shkeljes së të drejtave sociale ishin "shkurtimi i të drejtës për të marrë ndihmë sociale", dhe "pamundësimi i të drejtës së arsimit". Më shumë se gjysma e të anketuarve vendosën për opsionin e parë (51%). Pamundësimi i të drejtës së arsimit është zgjedhje e një të tretës së të anketuarve (33%). Nga informimet e anketuesve është shpjeguar se disa herë të anketuarit kanë komentuar se kjo e drejtë tani nuk shkelet dhe se të gjithë kanë të drejtë arsimit, kurse raste të tilla ka pasur vetëm në të kaluarën.

Pjesa tjetër 16% e të anketuarve nuk dinë ose e kuptojnë gabim shembullin e shkurtimit të të drejtave sociale.

Tabela 17

Sipas Jush, çfarë nga kjo që është dhënë është shkelje e të drejtave sociale?	Frekuenca	Përqindja
Shkurtimi i të drejtës për të marrë ndihmë sociale	681	51%
Vendosja e gjobave për parkim të gabuar	135	10%
Pamundësimi i të drejtës së arsimit	437	33%
Nuk e di	74	6%
Gjithsej	1327	100%

Dallimet e vetme interesante në lidhje me këtë pyetje shfaqen midis të anketuarve në bazë së përkatësisë së tyre etnike. Kështu, 73,7% e popullatës shqiptare e konsideron shkurtimin e të drejtës së marrjes së ndihmës sociale si shkelje të të drejtave sociale. Ky qëndrim është mjaft më i vogël te maqedonasit (45,6%) edhe pse është dominues për ta.

P11. Ku mund të kërkoni mbrojtje nëse konsideroni se ju janë shkelur të drejtat e njeriut?

Pyetja e fundit ishte në lidhje me institucionet ku mund të kërkohet mbrojtje nëse të anketuarit konsiderojnë se u janë shkelur të drejtat e njeriut. Sipas rezultateve të anketuarit më shpesh te Avokati i Popullit (27%) shikojnë institucionin ku mund të kërkohet mbrojtje nëse u janë shkurtuar të drejtat e njeriut. Nuk është i vogël besimi që të anketuarit e kanë edhe për organizatat joqeveritare të cilat merren me të drejtat e njeriut (15%) dhe avokatët 14%. Nga rezultatet e marra mund të vërehet se të anketuarit shprehën besim më të vogël për gjykatat në lidhje me këtë pyetje, vetëm 11%. Përgjigjet e tjera të përzgjedhura mund të shihen në tabelën më poshtë. Edhe për këtë pyetje të anketuarit kishin të drejtë të vendosin për më tepër se një përgjigje, por edhe të japin përgjigjen e vet nëse nuk është midis atyre të dhëna. Përgjigja e vetme e cila është dhënë, por nuk ishte midis atyre të ofruara është përgjigja "asgjëkund" përkatësisht "nuk i besoj asnjë institucioni" me 4%.

Tabela 18

Ku mund të kërkoni mbrojtje nëse konsideroni se ju janë shkelur të drejtat e njeriut	Frekuenca	Përqindja
Gjykatë	156	11%
Stacioni i policisë	129	9%
Avokati i Popullit	379	27%
Prokurori Publik	67	5%
Avokati	206	14%
OJQ	216	15%
Nuk e di	208	15%
Asgjëkund	64	4%
Gjithsej	1425	100%

Përsëri në lidhje me këtë pyetje nuk ka dallime të mëdha midis të anketuarve në lidhje me gjininë dhe moshën e tyre. Në aspektin e arsimit, besimin më të madh në OJQ si institucione ku mund të kërkohet mbrojtje tregojnë ata me arsim të lartë (24,5%) dhe ata me tituj mr. dhe dr. (23,5%). Me ta janë dakord vetëm 2,3% e atyre pa arsim tetëvjeçar. Në aspektin e përkatësisë etnike nuk ka dallime të mëdha me frekuencën e përgjithshme, përveç besimit të ulët ndaj OJQ-ve që mbizotëron te popullata shqiptare. Vetëm 2% e tyre kanë thënë se do t'i drejtoheshin për ndihmë OJQ-ve përkundrejt 18,8% e maqedonasve.

5. PËRFUNDIME

Pyetjet në këtë anketë kishin të bënin me disa aspekte: kuptimi i të drejtave të njeriut, njohja e formave të diskriminimit, informimi dhe vetëdija për lloje të caktuara të të drejtave të njeriut dhe informim në aspektin e institucioneve prej të cilave mund të kërkohet mbrojtje në raste të shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut dhe pasqyrimi ndaj diskriminimit.

Duke pasur parasysh analizën, të dhënat e marra dhe informacionet e anketuesve mund të nxirren disa përfundime dhe rekomandime në lidhje me mendimet, kuptimet dhe informimin e qytetarëve në lidhje me të drejtat e njeriut, diskriminimin dhe institucionet që merren me këto pyetje.

Aspekti themelor i cili shfaqet në të gjithë anketën është informimi i dobët dhe jo i tërësishëm në aspektin e të drejtave dhe lirive të njeriut nga të anketuarit. Pothuajse 70% e të anketuarve kanë mendim të gabuar në lidhje me faktin se çfarë janë të drejtat e njeriut, pastaj organizatën ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut e njohin më pak se gjysma e të anketuarve, më tepër se 60% nuk i njohin të drejtat ekonomike. Informimi jo i tërësishëm shfaqet në lidhje me format e diskriminimit, fjalorin të urrejtjes, kompetencat e policisë dhe të drejtat sociale. Tek të gjitha pyetjet ku janë dhënë lloje të shkeljes së të drejtave të njeriut një pjesë e të anketuarve nuk mund t'i njihte. Një pjesë e tyre kanë zgjedhur edhe shembuj të cilët nuk kanë të bëjnë me shkeljen e të drejtës së njeriut që është dhënë. Gjithashtu, të dhënat flasin se shkalla e arsimit ndikon mbi shkallën e informimit.

E gjithë kjo flet se ekziston nevoja për edukim shtesë, informim dhe ngritje të vetëdijes së qytetarëve për aspektet e ndryshme të praktikimit të të drejtave të njeriut në proceset shoqërore dhe në institucionet e shtetit.

Në aspektin e informimit për institucionet ku mund të drejtohen kur shkelen të drejtat, gjithashtu, ekziston informim i pamjaftueshëm. Më pak se një e treta e të anketuarve dinë se mund të drejtohen te Avokati i Popullit në rast të shkeljes së ndonjë të drejte të njeriut. Nga institucionet e dhëna besimi më i vogël është për gjykatat (11%). 15% e të anketuarve thonë se nuk dinë kujt t'i drejtohen, kurse 4% nuk kanë besim te asnjë institucion. Më pak se një e treta e të anketuarve e njohin Komisionin për Mbrojtje nga Diskriminimi si institucion ku mund të drejtohen në rast diskriminimi.

Në të vërtetë është e rëndësishme të përmendet se kudo ku ekzistonte mundësia që përkrah përgjigjeve të dhëna të jepet përgjigje që sipas të anketuarve më mirë e shpreh mendimin e tyre ishte: asnjë ose asgjëkund (në aspektin e institucioneve ku mund të drejtohen në raste të diskriminimit

apo shkeljes së të drejtave të njeriut). Mosbesimi i tillë lidhet me perceptimin ekzistues negativ për institucionet detyra e të cilave është mbrojtja e qytetarëve në raste të tilla, efikasiteti dhe konsistenca e tyre.

Të dhënat e tilla dëshmojnë se është e domosdoshme informimi për institucionet dhe mekanizmat ekzistuese për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Por, gjithashtu, duhet të punohet në zhvillimin e politikave nacionale të cilat e rrisin efikasitetin e institucioneve gjatë zbatimit të ligjeve dhe realizimit të të drejtave, kurse me këtë edhe besimin e qytetarëve në funksionimin e tyre.

Në vijim të këtij raporti janë rezultatet e përgjithshme me kryqëzim të pyetjeve me karakteristika të veçanta demografike të ekzemplarit (gjini, përkatësi etnike, arsim, moshë).



**RESEARCH ON
THE CITIZENS' UNDERSTANDING
AND AWARENESS OF HUMAN RIGHTS
AND PROTECTION MECHANISMS
IN CASE OF THEIR VIOLATION**

**RESEARCH ON
THE CITIZENS' UNDERSTANDING
AND AWARENESS OF HUMAN RIGHTS
AND PROTECTION MECHANISMS
IN CASE OF THEIR VIOLATION**



1. ABOUT THE PROJECT

The research was conducted as an activity within the project *“Increasing the transparency and improving the rule of law by monitoring and reporting violations of human rights in the Republic of Macedonia”*, conducted by the Helsinki Committee for Human Rights of the Republic of Macedonia, and supported by the Foundation Open Society - Macedonia.

The project *Increasing the transparency and improving the rule of law by monitoring and reporting violations of human rights in the Republic of Macedonia*, which was conducted from 01.01.2014 to 31.01.2015 had the goal to contribute towards providing increased legal certainty for the citizens of the Republic of Macedonia by informing the them about their rights, providing free legal assistance, monitoring court proceedings and notifying in cases of severe violations of human rights.

In order to fulfill the goal, the following activities were conducted:

1. Providing free legal assistance to individuals in the areas: freedom of expression, liberty and security, fair trial and non-discrimination
2. Monitoring court proceedings in the areas: freedom of expression, freedom and security, fair trial and non-discrimination
3. Monitoring the media from the aspect of freedom of expression and the political influence on the media
4. Publishing regular monthly reports with a description and assessment of public events, violations of human rights and democratic principles in the course of the ongoing month
5. Alerting the public about the more severe violations of human rights by means of regular press-conferences, briefings or announcements (alarms)
6. Conducting research on the citizens' understanding of human rights
7. Publishing an annual report on the situation with human rights
8. Coordination of an informal Network for Protection against Discrimination
9. Monitoring public assemblies, protests, strikes

When it comes to activity 6, i.e. conducting research on the citizens' understanding of human rights, the Institute of Social Sciences and Humanities - Skopje was chosen to conduct the research and prepare this report providing precise data on the research results, as well as an analysis and recommendations for future activities/actions towards increasing the citizens' awareness about their rights and protection mechanisms.

2. METHODOLOGY AND PROCEDURES USED IN THE RESEARCH PROCESS

INTRODUCTION

